

VENDIM
Nr.733, datë 7.11.2007

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT, PËR
HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË
SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe të zakonshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË SHTETIT TË IZRAELIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (këtu quhen “Palët”):

*me dëshirën për të zhvilluar më tej marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;
në përpjekje për të lehtësuar procedurat e udhëtimit për shtetasit e të dy vendeve,
kanë rënë dakord si më poshtë:*

Neni 1

Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të shërbimit ose të zakonshme, përjashtohen nga detyrimi për marrjen e vizës me qëllim hyrjen në territorin e Palës tjetër për një vizitë ose qëndrim që nuk i kalon nëntëdhjetë (90) ditë brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes së parë.

Neni 2

Shtetasve të secilit vend, që kanë ndër mend të qëndrojnë në territorin e vendit tjetër për një periudhë që i kalon nëntëdhjetë (90) ditë, u kërkohet të pajisen paraprakisht me viza.

Neni 3

Shtetasve të secilit vend, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, që ushtrojnë funksione zyrtare në vendin tjetër si anëtarë të një personeli diplomatik ose konsullor me qëndrim në territorin e Palës tjetër dhe të afërmyve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre, u kërkohet të pajisen me vizë tridhjetë (30) ditë nga data e hyrjes. Vizat e përmendura në këtë nen janë të vlefshme për periudhën e caktimit të tyre.

Neni 4

Vizat e përmendura në nenet 2-3 të kësaj Marrëveshjeje lëshohen falas nga misioni diplomatik

ose konsullor i vendit përkatës.

Neni 5

Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme kuptohet që qytetarët shqiptarë që hyjnë në Izrael dhe qytetarët izraelitë që hyjnë në Shqipëri nuk janë të përjashtuar nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregulloret e brendshme në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin apo profesionin për të huajt.

Neni 6

Secila Palë rezervon të drejtën të mos lejojë hyrjen për shtetasit e Palës tjetër, që ajo mund t'i konsiderojë të padëshirueshëm apo të shkurtojë periudhën e qëndrimit për këta shtetas.

Neni 7

1. Palët shkëmbejnë ekzemplarë të pasaportave të tyre të vlefshme nëpërmjet kanaleve diplomatike jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një Palë lëshon një model të ri të një pasaporte apo modifikon ato që janë shkëmbyer, Pala tjetër njoftohet për këto modifikime nëpërmjet kanaleve diplomatike tridhjetë (30) ditë para datës së hyrjes në fuqi të pasaportave të reja apo të modifikimeve. Njoftimi përfshin një ekzemplar të dokumenteve të reja apo të modifikuara dhe informacionin për zbatueshmërinë e tyre.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi për një periudhë fillestare prej një viti, nëntëdhjetë (90) ditë nga data e notës së dytë të notave diplomatike nëpërmjet të cilave Palët njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë respektuar. Kjo Marrëveshje zgjatet automatikisht për periudha shtesë prej një viti secila.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa një Palë njofton tjetrën nëpërmjet një note diplomatike në lidhje me synimin e saj për ta përfunduar atë, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para datës së përfundimit të synuar.

Neni 9

Shkëmbimi i notave të datës 28 nëntor 1993, që përbëjnë një Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Shtetit të Izraelit dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në lidhje me heqjen e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, shfuqizohet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 22 tetor 2007, që përputhet me ditën.....5768 në hebraisht, shqip dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentikë. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.